



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.84/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj – kryesuese, Skënder Çoçaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Srpska Lista, parashtuar kundër subjektit politik GI Novo Lice-Narodna Pravda, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Srpska Lista, ZL.Anr.84/2025 datë 30.09.2025.

II. Subjektit politik GI Novo Lice-Narodna Pravda, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik GI Novo Lice-Narodna Pravda, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet Subjekti politik GI Novo Lice-Narodna Pravda, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largojë posterin e vendosur në rrugën “Milan Radulovic Krcun bb” në Leposaviq, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datë 30.09.2025 ne PZAP, është parashtuar një ankesë, në të cilën pala ankuese ka pretenduar se më datë 29.09.2025 aktivistët e Listës Serbe në Komunën e Leposaviqit, kanë identifikuar se aktivistët e subjektit politik GI Novo Lice- Narodna Pravda kanë ngjitur poster promocional mbi posterin e vendosur nga Lista Serbe në rrugën “Milan Radulovic Krcun bb”, në Leposavic, duke e shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024, përkatësisht nenin 7 paragrafin 4. Tutje kanë theksuar se posterat e përmendur nga Lista Serbe u vendosen në përputhje me pëlqimin e banorëve të asaj ndërtese.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur fotografi, me te cilën e fakton se nje veprim i tille ka ndodhur.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik GI Novo Lice- Narodna Pravda, kanë deklaruar se para fushatës zgjedhore kanë vendosur afishe në vendet e përcaktuar me ligj dhe deri më tani nuk kanë pasur ndonjë vërejtje nga organet kompetente, ndërsa sa i përket territorit të Komunës së Leposaviqit përgjegjës për vendosjen e materialit promovues zgjedhor është përgjegjës aktivisti zgjedhor [REDAKTUAR], ndërsa një nga afishet e tij ishte marrë nga simpatizanti [REDAKTUAR] për ta vendosur në veturën e tij, mirëpo kur kishte parë se Srpska Lista e kishte vendosur posterin-banerin në hyrjen e ndërtesës ku jeton ai, i revoltuar dhe me vetë iniciativë kishte vendosur posterin e subjektit politik GI Novo Lice- Narodna Pravda, mbi atë të Srpska Lista. Në ankesë kanë theksuar se vet ky aktivist është deklaruar se e ka bërë në mënyrë të pavarur, pa dijeninë dhe pëlqimin e subjektit, dhe se është i gatshëm të deklarohet për këtë.

Tutje kanë theksuar se GI Novo Lice- Narodna Pravda nuk ka asnjë përgjegjësi apo rol në këtë veprim, dhe nuk ishte në dijeni që ishte ndërmarr ky veprim, kanë shtuar se Srpska Lista nuk ka marrë pëlqimin e banorëve për vendosjen e atij posteri, dhe që ankesa është paraqitur më vonesë, andaj në bazë të këtyre kanë propozuar që të refuzohet ankesa si e papabazuar.

Si provë kanë bashkangjitur disa fotografi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik Srpska Lista, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se subjekti politik kandidati GI Novo Lice- Narodna Pravda ka vendosur postera zgjedhorë mbi posterët e vendosur nga subjekti politik Srpska Lista në rrugën “Milan Radulovic Krcun bb”, duke shfrytëzuar hapësirën e cila ishte në shfrytëzim nga Srpska Lista.

Bazuar në këtë konkludohet se i njëjti ka shkelur Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nga se këto veprime bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se 1.1. *“heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga një subjekt tjetër politik;”*

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se subjekti politik GI Novo Lice- Narodna Pravda ka mbuluar posterin e vendosur nga subjekti politik Srpska Lista gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave për subjektin të cilit i takon dhe duke i mohuar te drejtën e ekspozimit të posterit subjektit tjetër. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimi i këtij aktivisti bien ndesh me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës zgjedhore nr.07/2024.

Paneli i ka shqyrtuar edhe pretendimet e dhëna në përgjigje të ankesës me të cilat kanë pretenduar se përgjegjës për vendosjen e posterave-banerave është simpatizanti – aktivisti [REDAKTUAR], i cili pa dijeninë e subjektit politik GI Novo Lice- Narodna Pravda, të njëjtat i ka refuzuar si të pabazuara, në pajtim me nenin 33 paragrafi 5, i Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet: *“Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkelje të këtij kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit, dhe kandidatët e tyre”*.

Paneli i ka vlerësuar edhe pretendimet e dhëna në përgjigje të ankesës me të cilat kanë pretenduar se ankesa është paraqitur pas afatit, paneli pas vlerësimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, vlerësoj se ankesa është paraqitur brenda afatit të caktuar kohor me ligj, nga se shkelja e pretenduar ka ndodhur me dt.29.09.2025, ndërsa ankesa është paraqitur me dt.30.09.2025, qka nënkupton se ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik GI Novo Lice- Narodna Pravda ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik GI Novo Lice- Narodna Pravda, si rrethanë lehtësuese ka marr faktin se ky subjekt më herët nuk ka bërë një shkelje të tillë, përkatësisht nuk është dënuar më parë për vendosjen e posterëve gjatë këtij procesi zgjedhor.

Paneli vlerëson se në rastin konkret subjekti politik GI Novo Lice- Narodna Pravda, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterin e vendosur mbi posterin e vendosur nga subjekti politik Srpska Lista në rrugën “Milan Radulovic Krcun bb”, në Leposaviq, ndërsa dëshmimi për t’iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 34 par.1 pika 1.1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.84/2025 më datën 03.10.2025

Kryesuese e Panelit,
Kymete Kicaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.